



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 18 shkurt 2020
Nr. ref.:RK 1516/20

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI39/19

Parashtrues

Raif Maloku

**Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktvendimit të Gjykatës
së Apelit, AC. nr. 4981/2017, të 15 majit 2018**

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Bajram Ljatifi, zëvendëskryetar
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërxhaliu-Krasniqi, gjyqtare
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare
Safet Hoxha, gjyqtar
Radomir Laban, gjyqtar
Remzije Istrefi-Peci, gjyqtare dhe
Nexhmi Rexhepi, gjyqtar

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa është parashtruar nga Raif Maloku nga Gjilani, me adresën aktuale në Zvicër (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i cili përfaqësohet nga Teuta Zhinipotoku, avokate nga Prishtina.

Vendimi i kontestuar

2. Parashtruesi i kërkesës e konteston kushtetutshmërinë e Aktvendimit të Gjykatës së Apelit, AC. nr. 4981/2017, të 15 majit 2018, në lidhje me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, CN. nr. 38/2016, të 10 tetorit 2017, Aktvendimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 12/2016, të 18 janarit 2016, Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, Ac. nr. 3824/2015, të 29 tetorit 2015, dhe Aktvendimin e Gjykatës Themelore, C. nr. 568/2014, të 14 prillit 2015.

Objekti i çështjes

3. Objekt i çështjes së kërkesës është vlerësimi i kushtetutshmërisë së të gjitha aktvendimeve të lartcekura me të cilat pretendohet se parashtruesit të kërkesës i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore kushtetuese të garantuara me nenin 3 [Barazia para Ligjit], nenin 16 [Epërsia e Kushtetutës], nenin 19 [Zbatimi i së Drejtës Ndërkombëtare] paragrafët 1 dhe 2, nenin 21 [Parimet e Përgjithshme], nenin 22 [Zbatimi i drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare], nenin 24 [Barazia para Ligjit], nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] paragrafët 1, 2 dhe 3, nenin 37 [E Drejta e Martesës dhe Familjes] dhe nenin 50 [Të Drejtat e Fëmijës] të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta).

Baza juridike

4. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 22 [Procedimi i kërkesës] dhe 47 [Kërkesa individuale] të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 32 [Parashtrimi i kërkesave dhe përgjigjeve] të Rregullores së punës të Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

5. Më 7 mars 2019, parashtruesi e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
6. Më 12 mars 2019, Kryetarja e Gjykatës e caktoi gjyqtaren Remzije Istrefi-Peci gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Arta Rama-Hajrizi (kryesuese), Gresa Caka-Nimani dhe Safet Hoxha.
7. Më 23 mars 2019, Gjykata e njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe kërkoi nga ai që të dorëzojë në Gjykatë të gjitha shkresat e lëndës.
8. Të njëjtën ditë, Gjykata e njoftoi Gjykatën e Apelit për regjistrimin e kërkesës.
9. Më 27 mars 2019, parashtruesi i kërkesës i dorëzoi të gjitha shkresat e lëndës.
10. Më 15 janar 2020, pas shqyrtimit të raportit të gjyqtarës raportuese, Kolegji shqyrtues njëzëri i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 13 gusht 2014, parashtruesi i kërkesës paraqiti padinë për zgjidhjen e martesës në Gjykatën Themelore në Gjilan kundër bashkëshortes e cila aktualisht banon në Zvicër.
12. Më 14 prill 2015, është mbajtur seanca dëgjimore në Gjykatën Themelore në lidhje me padinë e parashtruesit të kërkesës. Gjatë gjykimit, përfaqësuesja e parashtruesit të kërkesës dorëzoi në gjykatë një dokument të lëshuar nga autoritetet zvicerane. Pas leximit të këtij dokumenti, gjykata konkludoi se parashtruesi i kërkesës, më 13 janar 2014, kishte iniciuar në Zvicër procedurën për zgjidhjen e martesës me bashkëshorten dhe se kjo procedurë është në zhvillim e sipër, ndërsa padinë për zgjidhjen e martesës në Gjykatën Themelore në Gjilan e kishte paraqitur më 13 gusht 2014.
13. Rrjedhimisht, Gjykata Themelore, në të njëjtën ditë, nxori Aktvendimin C. nr. 568/2014, me të cilin e hodhi poshtë, si të palejuar, kërkesëpadinë e parashtruesit të kërkesës për zgjidhje të martesës.
14. Parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit ndaj Aktvendimit të Gjykatës Themelore C. nr. 568/2014.
15. Më 29 tetor 2015, Gjykata e Apelit nxori Aktvendimin Ac. nr. 3824/2015, me të cilin e refuzoi ankesën e parashtruesit të kërkesës dhe vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore C. nr. 568/2014. Në arsyetimin e Aktvendimit, gjykata theksoi:

“...gjykata e shkallës së parë, në kuptim të nenit 262 të LPK-së, ka konstatuar drejtë se në rastin konkret ekziston gjyqvarësia për të njëjtën kërkesëpadi, prandaj paditësi nuk ka pasur të drejtë që të iniciojë kontest të ri, gjykim i ri, në mes palëve të njëjta, prandaj, në këtë rast drejtë e ka zbatuar nenin 391 par. 1 pika c) e LPK-se, duke e hedhur poshtë si të palejuar padinë e paditësit.”
16. Parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë për revizion në Gjykatën Supreme kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit Ac. nr. 3824/2015.
17. Më 18 janar 2016, Gjykata Supreme nxori Aktvendimin Rev. nr. 12/2016, me të cilin e hodhi poshtë si të palejuar kërkesën e parashtruesit për revizion, duke theksuar se: *“...në kuptim të nenit 88 të Ligjit për Familjen të Kosovës (Ligji nr. 03/L-007) në këtë çështje juridike nuk mund të paraqitet revizion sepse nuk janë përmbushur kushtet ligjore për gëzimin e së drejtës për revizion në kontestet për zgjidhje të martesës, si në rastin konkret”.*
18. Parashtruesi i kërkesës paraqiti kërkesë në Gjykatën e Apelit për përsëritje të procedurës.
19. Më 10 tetor 2017, Gjykata e Apelit nxori Aktvendimin CN. nr. 38/2016, me të cilin e refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit për përsëritje të procedurës, duke theksuar se: *“Në këtë gjendje të çështjes juridiko-civile, pas*

ulerësimin të shkresave të lëndës dhe propozimit për përsëritjen e procedurës, kjo gjykatë ka gjetur se propozimi për përsëritjen e procedurës është i pa bazë dhe se i njëjti duhet të refuzohet. Kjo për faktin, sepse, në rastin konkret juridiko-civil, kjo gjykatë vlerëson se nuk janë plotësuar kushtet ligjore për përsëritjen e procedurës të përfunduar me aktvendimin e Gjykatës Themelore në Gjilan, të paraparë në dispozitën e nenit 232 par. 1 f) dhe g) të LPK-së...”

20. Parashtruesi i kërkesës paraqiti ankesë para Kolegjit të Gjykatës së Apelit ndaj Aktvendimit të Gjykatës së Apelit CN. nr. 38/2016.
21. Më 15 maj 2018, Kolegji i Gjykatës së Apelit nxori Aktvendimin AC. nr. 4981/17, me të cilin e refuzoi si të pa themeltë ankesën e parashtruesit të kërkesës, me arsyetim se: *„Gjykata e Apelit vlerëson se nuk ekzistojnë arsyet për përsëritje të procedurës sipas nenit 232 pika a), e) dhe c) të LPK-së, për të cilat ka paraqitur propozim për përsëritjen e procedurës i autorizuari i paditësit”*.

Pretendimet e parashtruesit

22. Gjykata rikujton se parashtruesi i kërkesës pretendon se i janë shkelur të drejtat dhe liritë themelore kushtetuese të garantuara me nenin 3, nenin 16, paragrafi 1, nenin 19, paragrafët 1 dhe 2, nenin 21, nenin 22, nenin 24, nenin 31, paragrafët 1, 2 dhe 3, nenin 37 dhe nenin 50 të Kushtetutës. Pretendimet e tij, parashtruesi i kërkesës i ndërlidh me mosvërtetimin nga ana e gjykatave të rregullta në Kosovë të ekzistimit apo të mosekzistimit të një procedure të mëhershme të shkurorëzimit në Zvicër.
23. Parashtruesi i kërkesës pretendon se *“... të gjitha aktvendimet e gjykatave të rregullta janë nxjerrë në kundërshtim me dispozitat e nenit 31 par. 1, par. 2 dhe par. 3 të Kushtetutës së Republikës së Kosovës si dhe dispozitat e ligjit në fuqi që kanë të bëjnë me publicitetin e shqyrtimit si dhe barazinë e palëve në procedurë (asnjëra instancë gjyqësore nuk ka mbajtur shqyrtim publik në lidhje me qështjen e adresuar). Në këtë mënyrë janë shkelur të drejta themelore të parapara me dispozitën kushtetuese nga neni 31 i Kushtetutës së Republikës së Kosovës”*.
24. Duke u thirrur në nenin 3 të Kushtetutës, parashtruesi i kërkesës pretendon se gjykatat e të gjitha instancave nuk e kanë respektuar parimin e barazisë së palëve në procedurë dhe kështu ky parim është shkelur në mënyrë flagrante.
25. Parashtruesi i kërkesës pretendon se *“aktvendimi i shkallës së dytë si dhe i shkallës së tretë (revizioni) nuk i kanë respektuar synimet e normës ligjore dhe sidomos normës kushtetuese sepse kanë paragjykuar në tërësi rastin e zhvilluar sipas tyre edhe pse pala ka parashtruar mjaft fakte dhe përmes apelimit të saj në të gjitha instancat e ka bërë të besueshëm faktin se nuk është zhvilluar procedura e divorcit në një shtet të huaj por se ka pasur procedurë divorci, kane mbajtur një seancë pranë Gjykatës së Rrethit në Lachen me të cilën Gjykata ka marrë një vendim për shkurorëzim të cilat ja ka dërguar në adresat e palëve në procedurë, mirëpo e paditura nuk e ka pranuar vendimin gjyqësor dhe pastaj e paditura ka bërë tërheqjen e padisë e pas paditëses edhe paditësi e ka tërhequr padinë për prishjen e martesës, ku me këtë është mbyllë qështja e shkurorëzimit pranë Shtetit Zviceran”*.

26. Parashtruesi i kërkesës tutje pretendon se “Aktvendimet e Gjykatës Supreme të Republikës së Kosovës si dhe aktvendimet e Gjykatës së Apelit në rastin konkret paraqesin një aspekt diskriminues ndaj palës e cila është e pambrojtur nga organet gjyqësore me vet faktin se parashtrimet e saj në asnjë instance gjyqësore nuk ishin vlerësuar dhe sikur shihet për mrekullinë tonë asnjë aktvendim nuk është meritör”.
27. Më konkretisht, parashtruesi i kërkesës pretendon se “Aktvendimet e gjykatave në fjalë nuk i kane mundësuar palës kërkuese një qasje në sistemin gjyqësor por ai është refuzuar në tërësi pa iu dhënë atij asnjë mundësi që të procedoj me provat të cilat ai kishte poseduar në realizimin e të drejtave të tij nga shërbimet e kryera konform ligjit në fuqi dhe normave standard të tij”.
28. Parashtruesi i kërkesës gjithashtu pretendon se gjykatat kompetente i kishin shkelur të drejtat e tij themelore të mbrojtura me ligj dhe me vetë Kushtetutën, pasi që nuk kanë pasur njohuri për marrjen e vendimit nga Gjykata e Apelit e Kosovës në lidhje me kërkesën për përsëritje të procedurës pasi që “Aktvendimi i është dorëzuar Av Y.H. dhe paditësi nuk ka qenë asnjëherë në njohuri për vendimin e marrë nga Gjykata sepse as Gjykata e as Av Y.H. nuk e kane njoftuar paditësin e as Av T.Zh. e cila ka qenë e autorizuar”.
29. Parashtruesi pretendon se “Autorizimin e dhënë Av Y.H. paditësi ja ka revokuar që nga Janari i vitit 2018, duke e autorizuar Av T.Zh. më dt. 27.02.2018, ku Avokatja T.Zh. i është drejtuar Gjykatës së Apelit me një parashtrësë të dt. 04.04.2018 dhe e ka bashkangjitur autorizimin në fjalë. Po ashtu me shkresë të ndryshme në vazhdimësi i është drejtuar po të njëjtës Gjykatë dhe atë më dt. 02.05.2018, 11.06.2018 dhe dt. 03.07.2018 me urgjencë për përshpejtimin e lëndës por asnjëherë e njëjta nuk ka pranuar përgjigje”. Në mbështetje të këtij pretendimi, parashtruesi i kërkesës deponoi në shkresat e lëndës një konfirmim nga avokati Y.H. (të vulosur dhe të nënshkruar).
30. Në fund, parashtruesi i kërkesës shton: “...i propozojmë Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës që duke u bazuar në Rregulloren e punës së kësaj Gjykate si dhe duke u bazuar në dispozitat e ligjit mbi Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, pas thirrjes së palëve për seancë të shqyrtimit publik ku do të paraqiten edhe prova shtesë, ose sipas vlerësimit të saj vet (jashtë seance) të nxjerrë vendim”.
31. Parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata që të aprovojë kërkesën e tij si të bazuar, të prishë të gjitha aktvendimet e gjykatave të rregullta dhe të kthejë çështjen në rivendosje. Gjithashtu, parashtruesi i kërkesës kërkon nga Gjykata t'i rekomandojë Gjykatës Supreme që atij t'i paguhen të gjitha shpenzimet e bëra gjatë zhvillimit të kësaj procedure.

Pranueshmëria e kërkesës

32. Gjykata së pari shqyrton nëse kërkesa i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, të përcaktuara me Kushtetutë, të parashikuara me Ligj dhe të parapara më tej me Rregullore të punës.

33. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet paragrafëve 1 dhe 7, të nenit 113 [Jurisdiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, të cilët përcaktojnë:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

(...)

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj.”

34. Gjykata në vazhdim shqyrton nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret e pranueshmërisë, siç përcaktohet në Ligj. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet neneve 48 [Saktësimi i kërkesës] dhe 49 [Afatet] të Ligjit, që përcaktojnë:

Neni 48 [Saktësimi i kërkesës]

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj.”

Neni 49 [Afatet]

“Kërkesa parashtrohet brenda afatit prej katër (4) muajve. Afati fillon të ecë që nga dita kur parashtruesit i është dorëzuar vendimi gjyqësor...”

35. Për më tepër, Gjykata merr parasysh rregullin 39 [Kriteret e pranueshmërisë], paragrafët (1) (c) dhe 3 (b) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

(1) *“Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të pranueshme nëse:*

[...]

(c) kërkesa parashtrohet brenda katër (4) muajsh nga dita kur vendimi i mjetit të fundit efektiv juridik i është dorëzuar parashtruesit.

(3) *Gjykata mund ta konsiderojë një kërkesë të papranueshme nëse ndonjë nga kushtet në vijim është i pranishëm:*

[...]

(b) kërkesa nuk është ratione materiae në pajtim me Kushtetutën;

[...].”

36. Duke i shqyrtuar shkresat e lëndës së parashtruesit të kërkesës, Gjykata gjen se ai kishte zhvilluar dy procedura gjyqësore para gjykatave të rregullta në Republikën e Kosovës.

Procedura e parë gjyqësore

37. Procedurën e parë gjyqësore, parashtruesi i kërkesës e inicioi më 13 gusht 2014 me padinë për zgjidhjen e martesës. Gjykata gjen se kjo procedurë e parë gjyqësore ka përfunduar me Aktvendimin e plotfuqishëm të Gjykatës Supreme, Rev. nr. 12/2016, të 18 janarit 2016.

38. Gjykata arriti në këtë përfundim duke i ndërlidhur gjetjet e saj në rastin konkret me rregulloret kushtetuese dhe ligjore, me të cilat parashikohet se kërkesa mund të parashtrohet në Gjykatë *“brenda katër (4) muajsh nga dita kur vendimi i mjetit të fundit efektiv juridik i është dorëzuar parashtruesit”*.
39. Lidhur me këtë, Gjykata rikujton se afati brenda të cilit parashtruesi i kërkesës ka pasur mundësi të dorëzojë kërkesën në Gjykatën Kushtetuese në lidhje me procedurën e parë gjyqësore, ka filluar të ecë prej ditës kur Aktvendimi i Gjykatës Supreme, Rev. nr. 12/2016, i është dorëzuar atij apo përfaqësuesit ligjor të tij, të cilin ai e kishte gjatë gjithë procedurës së parë gjyqësore, gjë që mund të vërehet në bazë të shkresave të lëndës dhe aktvendimeve të gjykatave të rregullta.
40. Rrjedhimisht, Gjykata konstaton se kërkesa lidhur me procedurën e parë gjyqësore është jashtë afatit kohor sepse nuk është parashtruar në pajtim me nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) të Rregullores së punës.

Procedura e dytë gjyqësore

41. Më tej, sa i përket procedurës së dytë gjyqësore, e cila është iniciuar nga parashtruesi duke paraqitur kërkesën në Gjykatën e Apelit, në të cilën kërkoi përsëritjen e procedurës dhe e cila përfundoi me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit AC. nr. 4981/17, të 15 majit 2018, Gjykata thekson se ajo nuk do të lëshohet në vetë analizën e pretendimeve të parashtruesit të kërkesës, dhe rrjedhimisht as në analizën e pretendimit se *„Autorizimin e dhënë avokatit Y.H. ai e ka revokuar që nga janari i vitit 2018, duke autorizuar avokat tjetër për ta përfaqësuar në procedurat e kërkesës për përsëritje të procedurës“*, dhe kjo për arsye se kërkesa në lidhje me këtë procedurë gjyqësore nuk është në pajtim me rregullin 39 (3) (b) të Rregullores së punës.
42. Më konkretisht, Gjykata, duke pasur parasysh se procedura konkrete ka të bëjë vetëm me çështjet që lidhen me përsëritjen e procedurës kontestimore, thekson se në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës *“Të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”*.
43. Lidhur me këtë, Gjykata, duke marrë parasysh pretendimet e parashtruesit të kërkesës për shkelje të nenit 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së, të cilat Gjykata mund t'i shqyrtojë vetëm në lidhje me kërkesën për përsëritje të procedurës gjyqësore, rikujton praktikën gjyqësore të GJEDNJ-së dhe praktikën e saj gjyqësore, sipas së cilës neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i KEDNJ-së nuk zbatohen në kërkesat për rishikimin ose përsëritjen e procedurës (shih, në mënyrë analoge, rastet e Gjykatës Kushtetuese: KI07/17/15, *Pashk Mirashi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 12 qershorit 2017, paragrafi 64; KI80/15, 81/15 dhe 82/15, *Rrahim Hoxha*, Aktvendim për papranueshmëri, i 27 dhjetorit 2016, paragrafi 31; KI76/18, *Pjetër Boçi*, Aktvendim për papranueshmëri, i 14 dhjetorit 2018, shih rastet e GJEDNJ-së, *inter alia*, *Oberschlick kundër Austrisë*, nr. 23727/94, Aktvendim për papranueshmëri, i 21 marsit 1994, *Dowsett kundër Mbretërisë së Bashkuar*, nr. 8559/08,

Aktvendim për papranueshmëri, i 4 janarit 2011, *Sablon kundër Belgjikës*, nr. 36445/97, Aktgjykim i 10 prillit 2001, paragrafi 86).

44. Gjithashtu, Gjykata rikujton se neni 6 i KEDNJ-së nuk zbatohet në përpjekjet e pasuksesshme për të rihapur një procedurë penale ose kontestimore, në bazë të fakteve të reja apo përmes procedurave të rishikimit të jashtëzakonshëm ose të posaçëm për arsye procedurale, të cilat nuk janë drejtpërdrejtë të disponueshme për personat fizikë dhe zbatimi i të cilave varet nga autorizimet diskrecionale të një autoriteti të caktuar (shih Vendimin e GJEDNJ-së *Tumilovich kundër Ruisë*, kërkesa 47033/99, të 22 qershorit 1999).
45. Për më tepër, neni 6 i KEDNJ-së nuk zbatohet përderisa autoritetet vendore nuk pranojnë të rihapin një procedurë, madje edhe në ato raste ku parashtruesi kishte paraqitur kërkesë për rihapje të procedurës në sajë të një aktgjykimi të mëparshëm të Gjykatës me të cilin është vërtetuar se ka pasur shkelje të Konventës në lidhje me procedurën e kontestuar para gjykatave vendore (shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së *Franz Fischer kundër Austrisë*, kërkesa nr. 37950/97, të 29 majit 2001). Megjithatë, në atë moment kur procedura rihapet ose kur aprovohet rishikimi i jashtëzakonshëm i procedurës, mekanizmat mbrojtës nga neni 6 i KEDNJ-së zbatohen për tërë procedurën gjyqësore (shih Vendimin e GJEDNJ-së *Vanyan kundër Ruisë*, kërkesa 53203/99, të 15 dhjetorit 2005, par. 56–58).
46. Në bazë të asaj që u tha, Gjykata konkludon se kërkesa e parashtruesit për përsëritje të procedurës gjyqësore nuk është *ratione materiae* në pajtim me nenin 31 të Kushtetutës në lidhje me nenin 6 të KEDNJ-së.
47. Prandaj, kërkesa e parashtruesit të kërkesës përkitazi me procedurën e dytë gjyqësore nuk është *ratione materiae* në pajtim me Kushtetuten sepse është jashtë juridiksionit gjyqësor dhe, si e tillë, duhet të refuzohet në pajtim me rregullin 39 (3) (b) të Rregullores së punës.
48. Në fund, Gjykata, duke pasur parasysh se procedura e parë gjyqësore ka përfunduar më 18 janar 2016, me Aktvendimin e Gjykatës Supreme, Rev. nr. 12/2016, e hodhi poshtë në bazë të nenit 49 të Ligjit dhe rregullit 39 (1) (c) të Rregullores së punës, ndërsa procedurën e dytë gjyqësore në lidhje me përsëritjen e procedurës e cila ka përfunduar me Aktvendimin e Gjykatës së Apelit, AC. nr. 4981/2017, të 15 majit 2018, e hodhi poshtë në bazë të rregullit 39 (3) (b) të Rregullores së punës. Gjykata gjithashtu thekson se nuk do të lëshohet më tej në analizën e pretendimeve të tjera të parashtruesit të kërkesës për shkeljet e neneve të tjera të Kushtetutës dhe KEDNJ-së.
49. Duke pasur parasysh të gjitha që u thanë më sipër, Gjykata gjithashtu refuzon edhe kërkesën e parashtruesit të kërkesës për mbajtje të seancës dëgjimore publike.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113.1 dhe 7 të Kushtetutës, nenin 49 të Ligjit dhe rregullin 39 (1) (c) dhe (3) (b) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 15 janar 2020, njëzëri,

VENDOS

- I. TË DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- III. TË PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit;
- IV. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtarja raportuese

Remzije Istrefi-Peci



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi